

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Objekti: Sifoni ujites dalja e rezervuarit Shumbat.

1. Marka C16/20 me inere të konsistencës 3-5 cm, granit deri 20mm, rere e lare me modul 2.6 cimento 400 kg, rere e lare m³ 0.43, granit m³ 0.69, uje m³ 0.18.

...Dozatura e mesiperme është e vlefshme për 1 m³ beton me cimento portland, dhe janë marrë nga Manuali i Projektimit të Betoneve. (Republika Shqiperise Ministria e Ndertimit)

2. Punime germim dheu

Kategoria e tokës për germim është kategoria e IV dhe V, konform Manualeve të Ndertimit vëllimi III. Të gjitha gërmimet të çfarëdo lloji të tokës që ndeshen, do të kryhen në thellësinë dhe gjerësinë e përcaktuar në vizatimet ose sipas udhëzimeve me shkrim të supervizorit të punimeve. Gjatë gërmimit, materiali i përshtatshëm për mbushje do të grumbullohet në një vend të përshtatshëm në një distancë nga bankinat për të shmangur mbingarkimin dhe t'i ruajë nga shembja anë të kanalit të gërmuar.

Kanalet do të gërmohen sipas profileve dhe seksioneve të përcaktuara në projekt.

Nivelimi do të bëhet në mënyrë të tillë që uji të mos vërshojë në kanale ose pjesë të tjera të gërmuara dhe çdo sasi uji e mbledhur do të hiqet me anë të pompave ose me metoda të tjera të aprovuara por gjithmonë brenda kostos së preventivit të punimeve.

Kanalet do të gërmohen në përmasat dhe nivelin e treguar në vizatimet përkatëse ose në përputhje me instruksionet me shkrim të supervizorit të punimeve. Zëri i treguar në tabelën e vëllimit lidhur me gërmimet do të përfshijë çdo lloj kategorie dheu, nëse nuk do të jetë e specifikuar ndryshe. Në rastin kur përdoren tuba shtesë, gërmimi me dorë i materialit të shtratit është i nevojshëm për çdo bashkim. Gërmimi me krah është gjithashtu i nevojshëm në afërsi të intersektimeve me infrastrukturën e tjera për të parandaluar dëmtimin e tyre.

Thellimet për pjesët lidhëse do të gërmohen më dorë, pasi fundi i kanalit të jetë i niveluar kanalet për tubacionet do të gërmohen në nivelin e ljesës së poshtme të tubacionit siç tregohet në vizatime, për të bërë të mundur realizimin e shtratit të kanalit, tubave të çelikut etj, me material të gërmuar.

3. Tubat prej polietileni.

Qellimi.

Ky seksion pershkruan tubat e kanalizimit me parete solide perez PE,(HDPE)dhe bashkuesit qe duhen furnizuar,ne komplet me materiale lidhese dhe aksesoret e tjere te nevojshem.Materialet. Te gjitha tubat HDPE dhe bashkuesit duhet te jene konform kerkesave te aplikueshme sipas standarteve te meposhtme.

Deri ne 250 mm, sipas standarteve te EU.

Trajtimi,transportimi.

Tubat,bashkuesit,aksesoret duhet qe te transportohe dhe magazinohen ne menyre qe te evitohen demtimet.tubat plastike duhet te hijezohen nese eshte e nevojshme ,per te parandaluar prkuljen per shkak te bymimit termik.Tubat e demtuara duhet te hiqen nga vendi i punes.Duhet te behet me kujdes transportimi i tyre per neteren qe te mos mehet demtimi i tyre.Te mbrohet nga demmtimi koka e tubave dhe te hiqen gjate punes ato te demtuarat.Tubat te pastrohen nga papastertite dhe te mbahen paster ne pergjegjesine e kontraktorit deri ne dorezimin e punimeve.Ne tub nuk duhet te futen rroba pune ,vegla apo materiale te tjera.Ngarkim dhe transport me shkarkim ,me cfare do mjeti,te materialit qe rezulton nga germimet ,prishjet etj,te cfare do natyre apo lloji,edhe ne qofte se eshte i lagur,per largimin e tyre nga kantjeri ne cfaredo distance dhe niveli,duke perfshire shkarkimindhe rrafshimin nese eshte i nevojshem.

Vendosja.

Tubacioni te vendoset sipas trasese dhe pjerresise se vizatimeve.latat ose piketat qe perdoren te vendosen ne intervale jo me shume se 5 m, per te kontrolluarnegradet e tubave. Dhe duhet te mbahen jo me pak setre lata gjate gjithë kohes qe behet gradimi i kanalit.Nqsperdoret instrument mates me lazer,matja periodike duhet te behet me instrument vezhgues per te vertetuar saktesine..Shtrirja e tubave.

Zhvendosja e njeanshme e tubit duhet te menjanohet gjate shtrimit.Tubat nuk duhet te vendosen ne uje ,as ne kushte te papershtatshme te kohes apo kanalit.Ne cdo moment qe shtrimi ndalon fundi i tubit duhet te mbyllet me kapak fundor,duke puthitur fundin e tubit per te mos lejuar futjen e reres apo te dheut ne tub.Tubat nuk duhet te ekspozohe ne diell pasi te jene vendosur ne kanal.

Bashkimi.

Te gjitha pergatitjet per bashkim dhe vete operacioni i bashkimit duhet te realizohen sipas instruksioneve dhe rekomandimeve te prodhuesit te tubit e cila shoqeron mallin.

Prova e pranimit.

Cdo kanalizim duhet te jete ne perputhje me kerkesat e probes se meposhtme te pranimit.Difektet te riparohen sipas pelqimit te suprevizorit.Prova duhet te behet me ngarkese te 1.5x presionit te se tubacinit.

Pershtataja .po te mos percaktohet ndryshe ne vizatime ,cdo seksion i linjes se kanalizimit

midis pusetave duhet te jete ei drejtedhe me pjerresi uniforme .Cdo seksion i tille miratohet nga Suprevizori.Kontraktori duhet te siguroje asistence te pershtatshme per te ndihmuar Suprevizorin.

Rrjedhjet.

Prova e rrjedhjeve duhet te behet ne cdo segment te sifonit midis Pusetave, dhe linja te provohet para mbulimit dhe para se ndonje tub te instalohet gjate punes se mbetur..pas kesaj prova duhet et behet pas mbulimit dhe ne segmente individuale apo te perbera sipas zgjedhjes se Suprevizorit.Prova e rrjedhjes behet duke bllokuar hapjet e pusetave ,pervec atyre qe lidhen me segmentet qe jane duke eu testuar,duke mbushur linjen dhe duke perdorur paisjet perkatese tepresionit.

Diferenca e presionit gjate 48 oreve nuk duhet te kaloje 0.5 perqind.Kontraktori duhet te siguroje, me shpenzimet e veta ,te gjithë paisjen me tuba midis segmentit qe duhet testuar dhe burimit te jesjellesit ,si dhe punet paisjet dhe materialet e kerkuara per provat.Metodat e perdorura koha e proves duhet te jene te pranueshme per Suprevizorin.

Shtrimi ne kanal.

Ne pergjithesi tubat HDPE shtrohen ne kanal ne varesi te kushteve klimatike te tokes , ne thellesine e projektit.karakteristikat gjeologjike te tokes dhe ngarkesa e trafikut ndikojne ne dimensionet ekanalit te ubit dhe ndikojne gjithashtu dhe ne kapacitetein e ngarkeses qe mban tubi vete.Gjersia e tabanit te kanalit kushtezohet nga diametri i jashtem i tubacionit si dhe domosdoshmeria e krijimit te nje hapesire punete dystuar.Duke ju permbajtur te dhenave te siperpermendura fundi i trasese duket te krijoje kushte optimale qe linja te mbivendoset ne te gjithë gjatesine e saj..Mbishtresezimet duhet te ndahen,mundesisht ne menyre te barabarte duke eleminuar keshtu presionin e ushtuar prej tyre.Tabani i kanalit nuk duhet te jete i shkriftezuar para vendosjes se tubit ne te kundert duhet te dystohet, shtypet ose te mbulohet me nje shtrese te posacme.Nqs kemi te bejme me shtrese shkembore duhet qe fundi i kanalit te ngrihet te pakten 0.15 m.Kesaj mund ti shtrohet rere,zhavorr i imet ose toke e paster dhe masa te ngjeshet.Ne rruget me trafik nuk lejohetqe tubat te shtrohen me mbulim me te vogel se 1 m.Ne raste te tilla propozohet nje veshje me beton.Duhet te behet kujdesqe fundi nkanalit ku do te shtrohen tubat te jete pa guere dhe i rrafshet.Nese kjo gjate germimit me eskavator nuk arrihet duhet te behet gemim me krahe ne 20 cm e fundit te kanalit.Kerkesat e meposhtme jane baze dhe duhen marre parasysht gjate shtimit te tubave HDPE ne perputhje me standartet.

-Perdorim i nje stafi te specializuar

-Paisja e mjaftueshme me mjete adekuate shtruse

-Mbykqyrje e vazhdueshme

-pranim i rregullt deri ne testin e sterilizimit

-perpilimi i dokumentacionit teknik/azhornimit.

Ndertimi i pusetave.

Kontraktori duhet te ndertoje pusetat ne pozicionet dhe pikat e percaktuara ne projekt,ose sicudhezohet nga Suprevizori. Pusetat do te lejojne hyrje per te bere inspektim dhe pastrim te kanaleve dhe do te jene vendosur ne pika ku ka ndryshim te drejtimeve,ndryshime te

madhësi se tubave, ndryshime të menjehershme të pjerresise. Gjate gjithë gjatesise se pusetes do të ndertohet një kanalsipas aksit të tubacionit të kanalizimit për të percjelle pa ndërprerje të prurjeve. Hapja e vrimave në degezime të mureve nuk behet pasi të jete betonuar por gjate procesit të ndertimit të behet degezimi perkates . Pasi të hapet gropa të kete kushte të pershtatshme për themelet e pusetes, dhe atehere të perdoret zhavorr dhe beton. ku

4. Punime Betonimi

Përpara së të fillojë procesi i përgatitjes së betonit , zona brenda armaturave, apo modinave duhet të jetë pastruar shumë mire me ujë ose ajër . Asnjë proces betonimi nuk duhet të kryhet derisa supervizori të ketë inspektuar dhe aprovuar gërmimin , masat e marra për mbrojtjen nga kushtet atmosferike , masat për shpërndarjen e ujit për freskim dhe stazhionim të betonit , fugat ndërtimore dhe fiksimin e fundeve , armimin si dhe të gjitha materialet e tjera për betonimin dhe masa të tjera në përgjithësi.

Materialet që do të përdoren për betonim dhe që do t'i nënshtrohet kontrollit të supervizorit janë çimentoja Portland e zakonshme që do të përdoret siaps standarteve të ISO ose ASTM c-150 , e cila do të përdoret për ato betone që nuk janë në presence të ujrave të zeza apo nëntokësore ose çimentoja Portland Sulfate që do të përdoret për betonet që janë në presence të ujrave sipërfaqësorë apo nëntokësorë. Inertet e imta për kategoritë e betonit C16/20 do të jenë prej rëre natyrale , gurë të shoshitur ose material të tjera me të njëjtat karakteristika apo kombinimin e tyre. E gjitha kjo duhet të jetë e pastruar mire , pa masa të mpiksura , cifla të buta e të veçanta , vajra , alkale , lëndë organike , argjile dhe sasi të substancave të tjera dëmtuese. Përmbajtja e lejueshme e limit dhe substancave të tjera dëmtuese është 5%.

Materialet e marra nga gurë të papërshtatshëm për inerte nuk duhet të përdoren për inerte të imta. Inertet që do të përdoren për miksimin e betonit nuk duhet të përmabjnë më shumë se 10% të materialit me të hollë se 0.1mm të hapësirës në rrjetë dhe jo më shumë se 5% të pjesës së mbetur në 2.4mm. site.

Inertet e trasha për betonin C16/20 do të përbëhen nga material guri të thyer apo të nxjerrë ose një kombinim i tyre me një masë jo më shumë se 20mm dhe do të jetë e pastër , e forte , e qëndrueshme, kubik dhe të formuar mire pa lëndë të buta apo të thërmushme, alkale, argjila apo vajra.

Kontraktori duhet të bëjë disa prova në kubikët e marrë si kampione dhe të shënojë inertet dhe fraksionimin e tyre , përzierjen e betonit në fillimin e punës për përgatitjen e betonit.

Këta kubikë duhet të testohen në laborator në kushte të njëjta nga 7 , 14 dhe 28 ditë dhe do të shoqërohen me fletë analize për çdo kubik.

5. Zëvendësimet

Zëvendësimi i materialeve të specifikuar në Dokumentin e Kontratës do të behet vetem me aprovimin e Mbikqyrësit të Punimeve në se materiali i propozuar për tu zëvendësuar është i njëjtë ose me i mirë se materialet e specifikuar, ose në se materialet e specifikuar nuk mund

të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e Kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Sipërmarrësit. Që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë, në formën e kuotimit të certifikuar dhe të datës së garancisë të dorëzimit nga furnizuesit e të dy materialeve, si të materialit të specifikuar ashtu edhe të atij që propozohet të ndryshohet.

6. Piketimi i punimeve

Sipërmarrësi, me shpenzimet e tij, duhet të bëjë ndërtimin e modinave dhe te piketave siç është parashikuar në projekt në përputhje me informacionin bazë të Punëdhënësit, dhe do të jetë përgjegjësi i vetëm për përpikmerinë dhe saktësinë e tyre. Sipërmarrësi do të jetë përgjegjës për të kontrolluar dhe verifikuar informacionin bazë që i është dhënë dhe në asnjë mënyrë nuk do të lehtësohet nga përgjegjësia e tij në se një informacion i tillë është i mangët, jo autentik ose jo korrekt. Ai nderkohë do të jetë subjekti që do të kontrollohet dhe rishikohet nga Punëdhënësi dhe në asnjë rast nuk i jepet e drejta të bëjë ndryshime në vizatimet e kontratës, për asnjë lloj kompensimi për korrigjimet e gabimeve ose të mangësive. Sipërmarrësi do të furnizojë dhe mirëmbajë me shpenzimet e tij rrethimin dhe materiale të tjera të tilla dhe të japë asistencë nëpërmjet një stafi të kualifikuar siç mund të kërkohet nga Punëdhënësi për kontrollin e modinave dhe piketave.

Sipërmarrësi do të ruajë të gjitha pikat e akseve, modinat, shënjat e kuotave, të bëra ose të vendosura gjatë punës, të mbulojë koston e rivendosjes së tyre nëse ato dëmtohen dhe të mbulojë të gjitha shpenzimet për ndreqjen e punës së bërë jo mirë për shkak të mosmirëmbajtjes, mbrojtjes ose spostimit pa autorizim të këtyre pikave të vendosura, modinave dhe piketave.

Përpara çdo aktiviteti ndërtimor, Sipërmarrësi do të ketë linjat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike të vendosura në terren, të drejtën e kalimit të qartë dhe të sheshuar, gati për fillimin e punimeve. Çdo punë e bërë jashtë akseve, kuotave dhe kufijve të treguara në vizatime ose të mosmiratuara nga Punëdhënësi nuk do të paguhet, dhe Sipërmarrësi do të mbulojë me shpenzimet e tij gërmimet shtesë gjithmonë nën drejtimin e Mbikqyrësit të Punimeve.

7. Dokumentat dhe vizatimet

Sipërmarrësi do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasinë dhe detajet të treguar në vizatimet, grafikët ose të dhëna të tjera dhe Punëdhënësi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mospërputhjeve nuk do ta lehtësojë Sipërmarrësin nga përgjegjësia për punë të pakënaqëshme. Sipërmarrësi do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në bërjen e llogaritjeve e volumeve, llojeve dhe sasive të materialeve dhe paisjeve të përfshira në punën që duhet kryer sipas Kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mospërputhje, ndërsa një udhezim i plotë do të jepet nga Punëdhënësi në se do të gjenden gabime të tilla ose mospërputhje

8. Fotografite e sheshit te ndertimit

Sipërmarresi duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbiqyresit të Punimeve në vendet e punës për të demonstruar kushtet e sheshit përpara fillimit, progresin gjatë punës së ndërtimit dhe mbas përfundimit të punimeve. Nuk do të bëhen pagesa për fotografimin e kantierit të punimeve pasi këto shpenzime janë parashikuar të mbulojnë në koston administrative të Sipërmarresit.

9. Mbrojtja e punës dhe e publikut

Sipërmarresi do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve të punësuar dhe të jetës publike. Masat e sigurimit paraprak të ligjeve të aplikueshme, kodeve të ndërtimit do të respektohen. Gjatë zbatimit të punimeve Sipërmarresi, me shpenzimet e veta, duhet të vendosi dhe të mirëmbajë gjatë natës pengesa të tilla dhe drita të cilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidentet.

10. Mbrojtja e ambientit

Sipërmarresi me shpenzimet e veta, duhet të ndermarre të gjitha veprimet e mundshme për të siguruar mbrojtjen e ambientit lokal të sheshit të ndërtimit.

Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i materialeve nga Sipërmarresi do të bëhet me makina të përshtatshme cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë dërdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makine që nuk plotëson këto kërkesa ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqen nga kantieri. Të gjitha materialet që sillen nga Sipërmarresi, duhet të sistemohen në mënyrë të përshtatshme për të mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar nga Mbiqyresi i Punimeve në çdo kohë.

Kostot e Sipërmarrësit për mobilizim dhe punime të përkohëshme

Do të kihet parasysh që Sipërmarrësit nuk do të bëhet asnjë pagesë mbi çmimet njësi të kuotuarat për kostot e mobilizimit, d.m.th. për sigurimin e transportit, dritën, energjinë, veglat dhe pajisjet, ose për furnizimin e godinës dhe mirëmbajtjen e impjanteve të ndërtimit, rrugëve të hyrjes, të komoditeteve sanitare, heqje e mbeturinave, punën, furnizimin me ujë, mbrojtjen kundër zjarrit, bangot e punës, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura të tjera të përkohëshme, pajisje dhe materiale, ose për kujdesin mjekësor dhe mbrojtjen e shëndetit, ose për patrullat dhe rojet, ose për ndonjë shërbim tjetër, lehtësi, gjëra, ose materiale të nevojshme ose që kërkohen për zbatimin e punimeve në përputhje me atë që është parashikuar në Kontratë.

Pastrimi perfundimtar i zones.

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme, Sipërmarrësi, me shpenzimet e tij, duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohëshme të çdo lloji dhe të lerë sheshin e tërë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme. Paguesa përfundimtare e Kontratës do të mbahet deri sa kjo të realizohet dhe pasi të jepet miratimi nga Mbikqyrësi i Punimeve.